



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI PËR PAKICAT KOMBËTARE
SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. Prot. _____ .

Tiranë, më ___ / ___ / 2023

Lënda: Mbi Performancën Financiare Buxhetore të Komitetit për Pakicat Kombëtare për 8-Mujorin e vitit 2023.

MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË

TIRANË

Komiteti për Pakicat Kombëtare (KPK), mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2023 ka synuar të garantojë gëzimin dhe ushtrimin e plotë të të drejtave individuale të personave që i përkasin pakicave kombëtare, për të mbrojtur identitetin e veçantë të pakicave kombëtare, mos diskriminimin dhe barazinë para ligjit.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06. 2008 ”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar , të ligjit nr.84, datë 24.11.2022 "Për buxhetin e vitit 2023", në lidhje me performancën financiare buxhetore, Komiteti për Pakicat Kombëtare ka vepruar me korrektësi, në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 06. 02. 2012, ”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, ndryshuar.

Buxheti i akorduar për Komitetin për Pakicat Kombëtare është pjesë e programit buxhetor **01150 “Shërbime të tjera”**. Ky buxhet është në funksion të realizimit të qëllimit të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit, i cili është sigurimi i ushtrimit të të drejtave specifike të personave që u përkasin një pakice kombëtare, si një përbërës thelbësor i një shoqërie të integruar dhe që garantojnë mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit.

Gjithashtu, ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivit të përcaktuar për këtë program buxhetor.

Në zbatim të Udhëzimit nr.22 dt.17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, po Ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2022, sipas modeleve standarde të monitorimit.

Komitetit të Pakicave Kombëtare i është akorduar një fond fillestar prej **40.281 (në mijë lekë)** për vitin 2023. Në muajin korrik 2023 Komitetit të Pakicave Kombëtare i është dhënë një fond shtesë për efektin financiar të pagave dhe sigurimeve shoqërore në vlerën 8,769 mijë lekë. Totali i vlerës së akorduar në vlerën 49,050 (mijë) lekë përbëhet nga:

Fondi i Pagave:	32,707	mijë lekë (zëri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	5,328	mijë lekë (zëri 601)
Fondi për Shpenzime Operative:	6.017	mijë lekë (zëri 602-606)
Fondi për Investime:	1.000	mijë lekë (zëri 231)
Fondi për projekte/nisma:	4.000	mijë lekë (zëri 604)

Nga fondi i planifikuar për vitin 2023 që është **49,050 (në mijë lekë)**, për periudhën e raportuar, KPK ka realizuar vlerën prej **26,641 (në mijë lekë)** ose **54.31 %** të buxhetit vjetor të akorduar.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zëri 600-601), në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Urdher të Kryeministrit Nr. 60 datë 01.04.2022 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Komitetit për Pakicat Kombëtare”, numri mesatar i punonjësve është realizuar 23 nëpunës, nga 24 të miratuar.

Nga fondi i pagave, sigurimeve shoqërore dhe shpërblimeve të planifikuar për vitin 2023 prej **38,033 (në mijë lekë)**, për këtë periudhë është realizuar **22,012 (në mijë lekë)** për paga dhe për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore ose **57.8 %** e fondit mujor të planifikuar në të dy zërat bashkë.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602-606); për 8-mujorin e vitit 2023, është planifikuar në vlerën **6.017 (në mijë lekë)**. Për periudhën respektive është realizuar vlera prej **1,589 (në mijë lekë)** ose **26.4 %** e fondit të vitit të planifikuar.

Fondi për financimin e projekteve/nismave (zëri 604); për 8-mujorin e vitit 2023, është planifikuar në vlerën **4,000 (në mijë lekë)**. Për periudhën respektive është realizuar vlera prej **3,039 (në mijë lekë)** ose **26.4 %** e fondit të vitit të planifikuar.

Lutemi gjeni bashkëlidhur Anekset nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5.

K R Y E T A R

Konstantina BEZIANI

Konceptoi: Genti Koti